

BASHKIA E XX NË PARTNERITET ME PROGRAMIN ReLOaD SHPALL:

THIRRJEN E DYTË PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR DORËZIMIN E PROJEKT PROPOZIMEVE NË PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (ReLOaD)

Programi Rajonal për Demokraci Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën¹, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë. Qëllimi i përgjithshëm i programit ReLOaD është që të fuqizojë demokracitë pjesëmarrëse dhe procesin e integritimit në BE në Ballkanin Perëndimor, duke e fuqizuar shoqërinë civile që të jetë pjesë e proceseve të vendimmarrjes si dhe duke kontribuar dhe mundësuar një mjedis ligjor dhe financiar inkurajues për shoqërinë civile.

Qëllimi specifik i këtij programi është fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet njësive të pushtetit vendor dhe shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor, duke inkurajuar zbatimin e modelit të suksesshëm të realizuar në Bosnje dhe Hercegovine lidhur me financimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) nga buxheti i pushtetit vendor në përputhje me prioritetet vendore. Programi ReLOaD do të promovojë sinergji ndërmjet bashkive dhe OShC-ve duke kontribuar në rritjen e cilësisë së jetesës në rreth 50 njësi të pushtetit vendor në gjithë Ballkanin Perëndimor të cilat priten të përfshihen dhe të kenë përfitime direkt në procese vendimmarrëse, gjithëpërfshirëse dhe transparente. Programi do të zbatohet për një periudhë 36 mujore (Janar 2017 – Janar 2020). Në kuadër të këtij programi, në Shqipëri pritet të zbatohen rreth 50 projekte të OShC-ve në 12 bashkitë partnere² dhe të ofrohen shërbime të përmirësuara dhe të shumëllojshme për qytetarët në këto bashki.

Për sa më sipër, Bashkia XX dhe programi ReLOaD fton të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) në Shqipëri që të paraqesin projekt-propozime që janë në përputhje me objektivat zhvillimore dhe prioritetet e Bashkisë XX si më poshtë:

1. 1. Prioriteti A
 - 1.1 A.i
 - 1.2 A.ii
 - 1.3 A.iii

¹ Të gjitha referencat lidhur me Kosovën duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 (1999)

² Durrës, Dibër, Shkodër, Prrenjas, Elbasan, Korçë, Librazhd, Tiranë, Tropojë, Roskovec, Përmet and Lezhë

- 2. Prioriteti B
 - 2.1 B. i
 - 2.2 B. ii
 - 2.3 B. Iii

- 3. Prioriteti C
 - 3.1 C. i
 - 3.2 C. ii
 - 3.3 C.iii

Shuma e fondeve për projektet e miratuara do të jetë nga 1.000.000 Lek deri 3.500.000 Lek.

OSHC-të mund të dorëzojnë më shumë se një projekt propozim nëse shuma totale nuk tejkalon shumën prej 7.000.000 Lek për gjithë kohëzgjatjen e projektit ReLOaD (Shkurt 2017 – Janar 2020).

Bashkia rezervon të drejtën të mos i alokojë të gjitha fondet që ka në dispozicion në rast se projekt-propozimet e paraqitura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara. Kohëzgjatja e secilit projekt mund të shkojë nga 6 deri në 8 muaj. Projektet e përzgjedhura duhet të zbatohen në periudhën nga muaji/20__ deri në muajin/20__.

PËRSHTATSHMËRIA/PRANUESHMËRIA:

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha OShC-të e regjistruara zyrtarisht (shoqata/organizata apo fondacion) në përputhje me ligjet dhe rregulloret e në fuqi në Shqipëri. **Të gjitha organizatat e shoqërisë civile të interesuara mund të gjejnë informacion të hollësishëm rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e projekteve në Udhëzimin për Aplikantë (Shtojca 6), pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.**

DOKUMENTACIONI:

Dokumentacioni i aplikimit për thirrjen publike të **Bashkisë XX** do të jetë i disponueshëm nga dita/muaji/20__, pas dërgimit të një kërkesë me e-mail në adresën xxxxx@ ku duhet ta citoni emrin e organizatës së interesuar; ose duke u paraqitur personalisht në **zyrën xxx (adresa, kodi postar, dhe qyteti)**. Të gjitha informatat e nevojshme, si dhe një version elektronik i paketës së aplikimit mund të gjendet edhe në web-faqen zyrtare të Bashkisë (XX) si dhe në web-faqen e UNDP (www.al.undp.org).

Me qëllim mbështetjen e OShC-ve për të paraqitur aplikime në përputhje me kriteret e Udhëzuesit, projekti ReLOaD do të organizojë takime informuese/ ditë të hapura, trajnime si dhe mbështetje specifike gjatë shkrimit të projekt - propozimit. Më konkretisht:

1. Bashkia XX do të organizojë një takim informues/ditë të hapur mbi Thirrjen e dytë publike, ku ftohen të marë pjesë të gjitha organizatat e interesuara për të aplikuar në përgjigje të kësaj Thirrjeje. Ky takim ka si qëllim, informimin e OShC-ve mbi

- elementët kryesorë të Thirrjes, duke u fokusuar tek elementët më të rëndësishëm për OSHC-të. Për Bashkinë XX takimi informues do të organizohet gjatë muajit **XX 2019**. Më shumë detaje për këtë aktiviteti do të jepen së shpejti nga Bashkita përkatëse nëpërmjet website.
2. Një trajnim tre ditor mbi ciklin e menaxhimit të projekteve për përfaqësuesit e të gjithë OSHCve të interesuara për të aplikuar në kuadër të kësaj Thirrjeje për Bashkinë XX do të organizohet gjatë muajit **XX 2019**. Trajnimi do të fokusohet në paketën e aplikimit të kësaj Thirrjeje, por do të përmbajë gjithashtu edhe njohuri të tjera më të gjera që lidhen me menaxhimin e projekteve. Më shumë detaje për këtë aktiviteti do të jepen së shpejti nga Bashkita përkatëse nëpërmjet website.
 3. Mbështetje konkrete për OSHC-të nëpërmjet ofrimit të këshillave për shkrimin e projekt-propozimit. Në Bashkinë XX, ekspertët e ReLOaD do të jenë të pranishëm në zyrat e Bashkisë, 3-4 ditë gjatë muajit **XX 2019**, për të organizuar sesione trajnimi specifike me organizata të cilat janë në fazën e shkrimit të projekt propozimit, në kuadër të kësaj Thirrjeje. Më shumë detaje për këtë aktiviteti do të jepen së shpejti nga Bashkita përkatëse nëpërmjet website.

Pyetje rreth ftesës publike mund të behën përmes e-mail adresës registry.al@undp.org, duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dërgohen deri me //20, ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data e pranimit të pyetjeve përkatëse. Për qëllime transparence, përgjigjet do t'u dërgohen gjithashtu të gjithë aplikantëve të mundshëm, ose do të botohen në faqen e internetit të bashkisë dhe/ose UNDP.

DORËZIMI I APLIKIMEVE:

Aplikimet e plotësuara (me të gjithë dokumentet mbështetëse) duhet të dorëzohen **në tri (3) kopje të shtypura dhe një koje elektronike (CD apo USB)**, të vendosura në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar referenca e thirrjes publike, përmes postës zyrtare apo personalisht, gjatë ditëve të punës (e hëne – e premte), nga ora 09:00 deri ora 15:00, në adresat në vijim:

Bashkia e XX

Afati për dorëzimin e aplikimeve është data __ / __ / 20__ , ora 15:00. Aplikimet e dorëzuara pas këtij afati do të merren parasysh vetëm nëse vula postare tregon se data dhe koha e dërgimit ka qenë para mbylljes së afatit zyrtar. Pjesa e jashtme e zarfit duhet të përmbajë titullin e thirrjes për dorëzimin e propozimeve, emrin dhe adresën e plotë të kandidatit, emrin e plotë të projektit dhe mbishkrimin “**Të mos hapet përpara hapjes zyrtare.**” Formulari për regjistrimin e dokumentacionit të pranuar lëshohet nga përfaqësuesi i bashkisë. Të gjithë aplikantët që kanë paraqitur propozime, pavarësisht nëse pranohen ose jo, njoftohen me shkrim për vendimin e marrë për projekt-propozimin e tyre brenda 30 ditëve pune nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet do të publikohen në faqen e internetit të bashkisë (www.....), në tabelën e njoftimeve të bashkisë, dhe në faqen e internetit të UNDP-së (www.al.undp.org).



Ky projekt është financiar nga Bashkimi Evropian

Logo e Bashkisë



Empowered lives.
Resilient nations.

PROGRAMI RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (ReLOaD)

UDHËZUES PËR APLIKANTËT – ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC-TË) NË KUADËR TË THIRRJES SË DYTË PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME NË PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (ReLOaD)

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë këshilla të qarta dhe koncize për të gjitha organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të interesuara në procesin e dorëzimit të projekt -propozimeve në kuadër të Thirrjes së Dytë Publike për OSHC-të në 12 bashkitë partnere të Programit ReLOaD në Shqipëri: Durrës, Dibër, Shkodër, Lezhë, Elbasan, Korçë, Prrenjas, Përmet, Tropojë, Librazhd, Tiranë dhe Roskovec.

1. ÇFARË ËSHTË PROGRAMI ReLOaD

Qëllimi i përgjithshëm i programit ReLOaD është që të fuqizojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritetit në BE në Ballkanin Perëndimor, duke mbështetur shoqërinë civile që të jetë pjesë e proceseve të vendimmarrjes si dhe duke stimuluar dhe krijuar një mjedis ligjor dhe financiar inkurajues për të.

Bazuar në eksperiencën e thelluar nga zbatimi i projektit të mëparshëm në Bosnje dhe Hercegovinë, **Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)** do të adresojë problematikat dhe sfidat në secilin prej vendeve pjesëmarrëse të Ballkanit Perëndimor: **Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë¹, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Mal të Zi, dhe Serbi.**

Qëllimi specifik i këtij programi është fuqizimi i bashkëpunimit midis qeverive lokale/bashkive dhe shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor, duke inkurajuar zbatimin e modelit të suksesshëm të realizuar në Bosnje dhe Hercegovinë lidhur me financimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) nga buxheti i bashkive në përputhje me prioritetet vendore. Programi synon që të sigurohet një qasje e qëndrueshme dhe transparente, e orientuar drejt zhvillimit dhe bazuar në projekte për financimin e OShC-ve nga buxhetet e bashkive. Programi do të ndihmojë në krijimin dhe fuqizimin e mekanizmave për monitorimin e aktiviteteve dhe rezultateve të projekteve të zbatuara nga OShC-të.

Programi ReLOaD do të promovojë sinergji ndërmjet njësive të pushtetit lokal dhe OShC-ve duke kontribuar në rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve në rreth 50 njësi të pushtetit lokal në gjithë Ballkanin Perëndimor, gjatë kohëzgjatjes 36 mujore, të cilat priten të përfshihen dhe të kenë përfitime direkt në procese vendimmarrëse, gjithëpërfshirëse dhe transparente.

¹ Të gjitha referencat lidhur me Kosovën duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 (1999)

Nëpërmjet programit ReLOaD në Shqipëri pritet të zbatohen rreth 50 projekte të OSHC-ve në 12 bashkitë partnere dhe të ofrojë shërbime të përmirësuara dhe të shumëllojshme për qytetarët që marrin shërbime në këto bashki. Nëpërmjet Thirrjes së Parë Publike për OSHC-të janë përzgjedhur tashmë 30 projekte, të cilat kanë filluar zbatimin në 12 bashkitë partnere që prej datës 1 Shtator 2018.

Disa nga rezultatet që projekti **ReLOaD** do të arrijë në 12 bashkitë në Shqipëri, dhe në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë:

- Bashkitë do të përdorin modele transparente dhe të bazuara në projekte konkrete për financimin e OSHC-ve;
- OSHC-të do të ofrojnë shërbime të cilat adresojnë nevojat e qytetarëve në bashkitë partnere dhe janë në zbatim të planeve dhe strategjive lokale për zhvillim;
- Kapacitete të fuqizuara të OSHC-ve dhe njësive të pushtetit vendor për të zbatuar skemat e grantit dhe ofruar projekte cilësore;
- Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal, dialogut, ndarjes së praktikave ndërmjet njësive të pushtetit vendor dhe OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor.

2. SYNIMI I PËRGJITHSHËM I THIRRJES PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME DHE PRIORITETET VENDORE

Nëpërmjet kësaj Thirrjeje publike synohet forcimi i partneritetit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe njësive të pushtetit vendor. Kjo do të arrihet nëpërmjet zbatimit të projekteve nga OSHC-të për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët. Në këtë kuadër, ftohen të gjitha OSHC-të e interesuara të dorëzojnë projekt-propozime, të cilat duhet të adresojnë prioritetet strategjike të Bashkisë XX, si më poshtë:

1. Prioriteti A
 - 1.1 A.i
 - 1.2 A.ii
 - 1.3 A.iii
2. Prioriteti B
 - 2.1 B. i
 - 2.2 B. ii
 - 2.3 B. iii
3. Prioriteti C
 - 3.1 C. i
 - 3.2 C. ii
 - 3.3 C. iii

Fondet do t'u ndahen atyre organizatave, projektet e të cilave i kontribuojnë zgjidhjes së një apo më shumë prioritetëve të Bashkisë përkatëse, që përmbushin kriteret e cilësisë dhe kushtet e tjera të kësaj thirrjeje publike, sikurse përcaktuar në këtë Udhëzues.

3. FONDET (GRANTET) QË JANË NË DISPOZICION PËR PROJEKTE

Vlera e granteve që ndahen si pjesë e kësaj thirrjeje publike duhet të jetë në mes të shumave minimale dhe maksimale si më poshtë:

- shuma minimale: 1.000.000 Lek
- shuma maksimale: 3.500.000 Lek

OSHC-të mund të dorëzojnë më shumë se një projekt propozim nëse shuma totale nuk tejkalon shumën prej 7.000.000 Lek për gjithë kohëzgjatjen e projektit ReLOaD (Shkurt 2017 – Janar 2020).

OSHC-të mund të aplikojnë në thirrjet e secilës nga 12 Bashkitë partnere të projektit ReLOaD.

Grantet e alokuara në këtë thirrje publike mund të mbulojnë shpenzimet administrative dhe shpenzimet e personelit deri në masën 30% të shumës së kërkuar. Ndërsa, pjesa tjetër prej 70% të fondeve, duhet të parashikohen për aktivitete programore të projektit.

Ndërkohë, 20% e vlerës totale mund të parashikohet për blerje pajisjesh dhe 30% për rikonstrukcione/infrastrukturë, vetëm në rastet kur janë të domosdoshme për realizimin e qëllimit të projekt propozimit.

Për secilin projekt, 4 – 6% e vlerës totale të propozuar duhet të parashikohet për aktivitete që lidhen me dukshmërinë/vizibilitetin.

Totali i grantit në Bashkinë XX për këtë Thirrje është: _____ Lek.

Bashkitë partnere dhe UNDP kanë të drejtën për të mos ndarë të gjitha fondet në dispozicion nëse projekt-propozimet që dorëzohen nga OSHC nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.

4. KUSH MUND TË APLIKOJË

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur dhe e barabartë për OSHC-të (shoqatat ose fondacionet) që janë zyrtarisht të regjistruara dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Shqipëri.

OSHC-të do të përjashtohen nga pjesëmarrja në thirrje apo nga ndarja e granteve nëse në kohën e dorëzimit të projekt propozimeve:

- janë degë/zyra të organizatave dhe fondacioneve ndërkombëtare, dhe organizatat të tjera ndërkombëtare jo-fitimprurëse të regjistruara për të punuar në Shqipëri;
- janë subjekt i ndonjë konflikti të interesit, sikurse parashikuar në dispozitat e Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Më konkretisht, përjashtohen nga vlerësimi ato projekte, në të cilat: *Drejtori ekzekutiv, anëtarët e bordit apo personat e planifikuar për tu përfshirë në projekt janë të punësuar në bashkinë apo institucionet e saj të vartësisë në të cilën aplikohet, në pozicionet: Zyrtari i nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues sipas legjislacionit të shërbimit civil² si dhe anëtar i Këshillit Bashkiak, anëtar i kabinetit të Kryetarit të Bashkisë.*

² Neni 31 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

- janë fajtorë për dhënien e informacionit të rremë një pale kontraktuese të autorizuar, që kërkohet si parakusht për pjesëmarrje në thirrjen për dorëzimin e projekt-propozimeve ose nëse nuk dorëzojnë informacionin e kërkuar;
- janë përpjekur të sigurojnë informacion konfidencial, të ushtrojnë ndikim mbi Komisionin e Vlerësimit ose mbi një palë të autorizuar kontraktuale gjatë procesit të vlerësimit të projekt-propozimit;
- nuk kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme sipas pikës 9;
- vlera e buxhetit të propozuar është më e ulët se shuma minimale prej 1.000.000 ALL ose më e lartë nga shuma maksimale prej 3.500.000 ALL;
- kohëzgjatja e propozuar e projektit është më e shkurtër se 6 muaj ose më e gjatë se 8 muaj;

5 . KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e projekt – propozimit mund të jetë nga 6 deri në 8 muaj.

6. VENDI I ZBATIMIT

Projektet duhet të zbatohen ekskluzivisht në territorin e Bashkisë XX.

7. LLOJET E PROJEKTEVE

- Projekt-propozimet që do të financohen nga programi ReLOaD duhet të jenë të përgatitura në përputhje me thirrjen publike dhe prioritetet e Bashkisë XX.
- Projektet duhet të ofrojnë zgjidhje për nevojat specifike të komunitetit lokal dhe grupeve të targetuara të identifikuara nga projekti.
- Projektet duhet të jenë paketa veprimtarish të integruara dhe metodologjike, të krijuara për të arritur qëllime të caktuara dhe rezultate specifike në kuadër të një periudhe të kufizuar kohore.

Aktivitetet në vijim nuk rekomandohen për ndarjen e granteve:

- Aktivitetet e rregullta të organizatës aplikuese apo organizatës partnere;
- Sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në seminare, konferenca, kongrese;
- Bursat individuale për studime apo kurse trajnimi;
- Konferenca të herëpashershme (përveç nëse janë të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit);
- Financimi i projekteve që tanimë janë në proces ose kanë përfunduar;
- Projektet për përfitime ekskluzive të individëve;

- Projektet që mbështesin partitë politike;
- Ndarjen e granteve për palë të treta;
- Blerja e pajisjeve dhe punët rehabilituese/ndërhyrjet në infrastrukturë përveç rasteve kur janë patjetër të domosdoshme dhe brënda limiteve të shprehura në pikën 3 të Udhëzuesit.

Aktivitet e sipërpërmendura **NUK** janë shkak për refuzimin automatik të projekt - propozimit, megjithatë do të ndikojnë negativisht në vlerësimin e projekt propozimit. Gjithashtu, nëse projekt – propozimi aprovohet për financim, aktivitete të tilla dhe fondet e parashikuara për to do të eliminohen.

8. PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMI

OSHC-të e interesuara mund të aplikojnë në mënyrë individuale ose në partneritet me organizata dhe/ose institucione të tjera.

Organizatat partnere

Partnerë të projektit mund të jenë organizata të tjera të shoqërisë civile. Partnerët e OShC-së kandidate marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e projektit, dhe shpenzimet u nënshtrohen rregullave të njëjta si ato të bëra nga vetë OShC-ja kandidate. Në këtë mënyrë, organizata partnere duhet të përmbushë kushtet e njëjta të legjitimitetit sikurse edhe organizata aplikuese. Nëse aplikojnë në partneritet, organizata aplikuese do të jetë organizata udhëheqëse, dhe në rast të përzgjedhjes, kjo organizatë do të jetë pala kontraktuese (përfituese) dhe do t'i marrë të gjitha përgjegjësitë ligjore dhe financiare për zbatimin e projektit. **Deklarata e Partneritetit** (Shtojca A) duhet të plotësohet në mënyrë korrekte dhe duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e tjera të aplikimit.

Bashkëpunëtorët: organizata dhe institucione te tjera

Organizatat dhe/apo institucionet tjera (p.sh. shkollat, kopshtet e fëmijëve, muzetë, etj) mund të përfshihen në projekt. Organizatat e tilla – bashkëpunëtorët kanë rol të rëndësishëm në zbatimin e aktiviteteve, mirëpo nuk mund të marrin grante.

9. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR TË APLIKUAR

I. Dokumentet kryesore:

- Projekt propozimi (në formatin Word - Shtojca 7)
- Buxheti (formati Excel - Shtojca 8)
- Matrica e kornizës logjike (formati Word – Shtojca 9)
- Plani i aktiviteteve dhe dukshmërisë (formati Excel – Shtojca 10)

II. Dokumente shitesë (për organizatën aplikuese dhe partnerët, nëse ka)

- Vendimi i regjistrimit të organizatës në Gjykatë dhe ndryshime të tij nëse ka patur.
- Kopja e statutit të organizatës (për organizatën aplikuese dhe partnerët, nëse ka),
- Formulari i kompletuar identifikues administrativ (formati Word– Shtojca 11),

- Formulari i kompletuar identifikues Financiar (formati Excel– Shtojca 12),
- Deklarata e plotësimit të kriterëve e plotësuar dhe e nënshkruar (formati Word – Shtojca 13),
- Kopje e Pasqyrave financiare të OSHC-së (a. bilanci; b. PASH; c. cash flow; ç. shënimet shpjeguese) për vitin paraardhës e firmosur nga një kontabilist i miratuar, përveç rasteve nëse organizata është themeluar gjatë këtij viti.
- Një raport përshkruar i projekteve dhe aktiviteteve të OSHC për vitin paraardhës, përveç rasteve nëse organizata është themeluar gjatë këtij viti.
- Deklarata e partneritetit në rast se OSHC aplikuese ka partnerë (shtojca A).
- Deklarata e shmangies së konfliktit të interesit (shtojca B).

Shënim: Me qëllim vlerësimin e projekt – propozimit, dokumentacioni kryesor dhe ai shitesë janë njësoj të vlefshme dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të sipër përmendura në 3 kopje është i detyrueshëm.

10. KUR DHE KU TË MERRET DHE TË DORËZOHET PAKETA E APLIKIMIT

Dokumentacioni për thirrjen publike për Bashkinë e XX mund të tërhiqet prej **DITA, DATA ___ (dita e hapjes së Thirrjes Publike)** deri në **DITËN, DATËN _____ (dita e mbylljes së Thirrjes Publike)** duke e dërguar një kërkesë me emrin e organizatës së interesuar në e-mail adresën: XX apo personalisht, në adresën:

Bashkia e XX
Adresa fizike

Informacioni përkatës si dhe një version elektronik i të gjithë paketës së aplikimit mund të merret edhe nga faqja e internetit: XX

Aplikimet e plotësuar me të gjithë dokumentacionin, duhet të dorëzohen **në tri (3) kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (në CD apo USB)** përmes postës zyrtare apo personalisht, të vendosura në një zarf të vulosur që i referohet thirrjes publike, gjatë ditëve të punës (prej të hënës deri të premten), nga ora 09:00 deri në ora 15:00, në adresën:

Bashkia e XX

Afati për dorëzimin e aplikimeve është XX në ora 15:00 (6 javë nga data e hapjes së Thirrjes Publike). Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të jenë shkruar emri i thirrjes publike për projekt-propozime, emri i plotë dhe adresa e aplikantit, emri i plotë i projektit dhe fjalët: ”Të mos hapet përpara hapjes zyrtare”. Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (p.sh. me faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresa tjera nuk do të merren parasysh.

Bashkia do të regjistrojë çdo aplikim të marrë në dorëzim dhe do të lëshojë vërtetimin përkatës (datën dhe orën e pranimit të projekt-propozimit).

11. INFORMACION TJETËR

Me qëllim mbështetjen e OSHC-ve për të paraqitur aplikime në përputhje me kriteret e Udhëzuesit, projekti ReLOaD do të organizojë takime informuese/ ditë të hapura, trajnime si dhe mbështetje specifike gjatë shkëmbimit të projekt - propozimit. Më konkretisht:

1. Bashkia XX do të organizojë një takim informues/ditë të hapur mbi Thirrjen e dytë publike, ku ftohen të marri pjesë të gjitha organizatat e interesuara për të aplikuar në përgjigje të kësaj Thirrjeje. Ky takim ka si qëllim, informimin e OSHC-ve mbi elementët kryesorë të Thirrjes, duke u fokusuar tek elementët më të rëndësishëm për OSHC-të. Për Bashkinë XX takimi informues do të organizohet gjatë muajit **XX 2019**. Më shumë detaje për këtë aktiviteti do të jepen së shpejti nga Bashkita përkatëse nëpërmjet website.
2. Një trajnim tre ditor mbi ciklin e menaxhimit të projekteve për përfaqësuesit e të gjithë OSHC-ve të interesuara për të aplikuar në kuadër të kësaj Thirrjeje për Bashkinë XX do të organizohet gjatë muajit **XX 2019**. Trajnimi do të fokusohet në paketën e aplikimit të kësaj Thirrjeje, por do të përmbajë gjithashtu edhe njohuri të tjera më të gjera që lidhen me menaxhimin e projekteve. Më shumë detaje për këtë aktiviteti do të jepen së shpejti nga Bashkita përkatëse nëpërmjet website.
3. Mbështetje konkrete për OSHC-të nëpërmjet ofrimit të këshillave për shkrimin e projekt-propozimit. Në Bashkinë XX, ekspertët e ReLOaD do të jenë të pranishëm në zyrat e Bashkisë, 3-4 ditë gjatë muajit **XX 2019**, për të organizuar sesione trajnimi specifike me organizata të cilat janë në fazën e shkrimit të projekt propozimit, në kuadër të kësaj Thirrjeje. Më shumë detaje për këtë aktiviteti do të jepen së shpejti nga Bashkita përkatëse nëpërmjet website.

Pyetje rreth ftesës publike mund të behën përmes e-mail adresës registry.al@undp.org, duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dërgohen deri me //20, ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data e pranimit të pyetjeve përkatëse. Për qëllime transparence, përgjigjet do t'u dërgohen gjithashtu të gjithë aplikantëve të mundshëm, ose do të botohen në faqen e internetit të bashkisë dhe/ose UNDP.

12. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PROJEKT-PROPOZIMEVE

Vlerësimi

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e UNDP, përfaqësuesit e Bashkisë XX, dhe përfaqësuesi i shoqërisë civile.

Shënim: OSHC-ja, përfaqësuesi i së cilës është anëtari i Komisionit të vlerësimit në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë civile, nuk ka të drejtë të aplikojë në këtë thirrje as si aplikant kryesor dhe as si partner. Përfaqësuesi i shoqërisë civile në cilësinë e anëtarit të Komisionit të vlerësimit, zgjidhet me një proces të hapur dhe konkurrues.

Projekt propozimet me pikët më të larta, do të propozohen për miratim përfundimtar Bordit të Partnerëve të Projektit ReLOaD në Shqipëri, i cili përbëhet nga përfaqësues të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, UNDP, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia për mbështetjen e shoqërisë civile, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, Shoqata për Autonomi Vendore dhe përfaqësues nga OSHC në Shqipëri.

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

(i) Kritereve administrative:

- Aplikimi është dorëzuar brenda afatit, specifikuar në seksionin 10 të këtij Udhëzuesi;
- Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të seksionit nr. 9;

- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (CD apo USB).
- Konfirmimi se organizata aplikuese, partneri (dhe bashkëpunëtorët, nëse ka ndonjë) dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuara në seksionet 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 (të përcaktuara më sipër).

(ii) Kriteret e përmbajtjes/vlerësimi i cilësisë së projektit dhe vlerësimi financiar:

Vlerësimi i cilësisë së projektit, përfshirë edhe buxhetin e propozuar, do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuara në Tabelën Vlerësuese që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

Sistemi i vlerësimit është si më poshtë:

Kriteret e vlerësimit ndahen në seksione dhe nën-seksione: ***Secili nën-seksion duhet të vlerësohet me pikët e caktuara nga 1 në 5, në këtë mënyrë: 1= shumë keq; 2= keq; 3= pranueshëm; 4= mirë; 5= shumë mirë.*** Secili anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësuese dhe të gjithë anëtarët e nënshkruajnë tabelën vlerësuese përmbledhëse për secilin projekt propozim. Radhitja e projekt propozimeve bëhet në atë mënyrë ku projekt propozimi i radhitur si i pari është ai i cili ka fituar numrin më të lartë të pikëve deri tek projekt propozimi me numrin më të ulët të pikëve.

- Pikët maksimale të vlerësimit për një projekt – propozim janë 100;
- Projektet të cilat aplikojnë për një shumë granti nga 1.000.000 – 2.000.000 Lek, do të meren në konsideratë për dhënien e grantit, vetëm nëse vlerësohen me më shumë se 50 pikë;
- Projektet të cilat aplikojnë për një shumë granti nga 2.000.001 – 3.500.000 Lek do të meren në konsideratë për dhënien e grantit vetëm nëse vlerësohen me më shumë se 75 pikë.

Vendimi për aprovimin e grantit mbështetet mbi numrin e përgjithshëm të projekteve që mund të financohen me buxhetin në dispozicion. Projektet që kanë fituar numër më të madh të pikëve do të kenë prioritet gjatë dhënies së granteve.

Shënim për Seksionin 1/Tabela e Vlerësimit: Kapaciteti financiar dhe operativ i organizatës aplikuese

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 10 ose më shumë pikë, në seksionin 1. Kjo nënkupton që organizatat kanë në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për financimin e aktiviteteve të rregullta gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit si dhe kanë aftësi profesionale dhe kualifikime të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm të projektit. E njëjta vlen si për organizatën aplikuese ashtu edhe për partnerët.

Projekti përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve në Seksionin 1 është më i ulët se 10 pikë.

Shënim për Seksionin 2/Tabela e Vlerësimit: Relevanca

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 18 ose më shumë pikë, në seksionin 2. Kjo nënkupton që projekti duhet të jetë relevant me qëllimin e thirrjes publike dhe fushat

prioritare, cilësia e projektit, rezultatet e pritshme dhe qëndrueshmëria e projektit janë të konsiderueshme si dhe fondet që kërkohen janë në përputhje me aktivitetet e parashikuara.

Projekti përjashtohet nga shqyrtimi i mëtejshëm në rast se numri total i pikëve në Seksionin 2 është më i ulët se 18 pikë, sepse pikët tregojnë se megjithëse aplikanti i ka kapacitetet financiare dhe operative, koncepti i projektit nuk është relevant apo në përputhje me përparësitë e përcaktuara në thirrjen publike/ projekti nuk trajton nevojat e komunitetit.

Tabela e vlerësimit

Seksioni	Pikët maksimale	Pikët mesatare
1. Kapacitetet financiare dhe operative	15	
1.1 A kanë aplikanti dhe partnerët përvojë të mjaftueshme në menaxhim projektesh? Vlerësim maksimal marin organizatat që kanë të paktën 3 projekte të zbatuara apo në zbatim	5	
1.2 A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën relevante) Vlerësim maksimal marin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte në fushën për të cilën aplikojnë.	5	
1.3. A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme menaxhuese? (përfshirë personelin, pajisjet dhe kapacitetet për menaxhim financiar)? Vlerësim maksimal marin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte me shuma mbi 10.000 Euro.	5	
2. Relevanca	25	
2.1. Sa relevant është projekti krahasuar me synimin dhe me një apo më shumë përparësi të përcaktuara në thirrjen publike? Shënim: 5 pikë (shumë mirë) mund të jepen vetëm nëse projekti trajton të paktën njërin prej përparësive të bëra publike në thirrjen e shpallur	5	
2.2 A janë palët e interesuara të përcaktuara qartë dhe të përzgjedhura në mënyrë strategjike (bashkëpunëtorët, përfituesit përfundimtarë, grupet e synuara)?	5	
2.3 A janë nevojat e grupit të synuar dhe përfituesve përfundimtarë të përcaktuara qartë dhe a i trajton projekti ato në mënyrën e duhur?	5	
II.4 A përfshin projekti vlerë të shtuar, si qasje inovative dhe modele të praktikës së mirë? Vlerësim maksimal marin aplikimet të cilat sjellin risi në zbatimin e projekteve në bashkinë përkatëse.	5	
II.5 A bën projekti avokim për një qasje të bazuar tek të drejtat dhe a ka ndikim pozitiv tek grupet e pafavorizuara? (Promovimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të grave, mbrojtja e mjedisit, bashkëpunimi ndërkombëtar, rinia, etj.) Vlerësim maksimal marin aplikimet, të cilat ndikojnë në të paktën 2 grupe të marginalizuara	5	
3. Metodologjia	20	
3.1 A përshtaten plani i aktiviteteve dhe aktivitetet e propozuara në mënyrë logjike dhe praktike me qëllimet dhe rezultatet e pritshme?	5	
3.2 Sa konsistente është skema e përgjithshme e projektit? (veçanërisht, a e pasqyron analizën e problemeve të identifikuar, faktorët e mundshëm të jashtëm) Vlerësim maksimal marin aplikimet, në të cilat janë marë në konsideratë faktorët e jashtëm (sipas logframe) dhe janë prezantuar masa për eliminimin e tyre.	5	
3.3 A është i kënaqshëm niveli i përfshirjes së partnerëve në zbatimin e projektit? Shënim: nëse nuk ka asnjë partner pikët e përfituara do të jenë 1. Këtu nuk përfshihen bashkëpunëtorët.	5	
3.4 A janë përfshirë në projekt tregues objektivist të matshëm? Vlerësim maksimal marin aplikimet, të cilat në logframe kanë indikatorë të qartë e të matshëm.	5	
4. Qëndrueshmëria	25	
4.1 A do të kenë veprimtaritë e propozuara ndikim konkret tek grupet e synuara? Vlerësim maksimal marin aplikimet të cilat lidhin aktivitetet e propozuara me grupet e synuara.	5	
4.2 A do të ketë projekti ndikime të shumëfishta? (përfshirë mundësinë e zbatimit në grupe të tjera të synuara ose në vende të tjera dhe/ose shtrirjen e ndikimit të veprimtarive si dhe shkëmbimin e informacionit për përvojën e fituar gjatë zbatimit të projektit)	5	

4.3 A janë rezultatet e pritshme të veprimtarive të sugjeruara të qëndrueshme nga ana institucionale? (a do të ekzistojnë strukturat që mundësojnë veprimtaritë e projektit pas përfundimit të projektit? A do të ketë pronësi lokale mbi rezultatet e projektit?)	5	
4.4 A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme? (aty ku është rasti, përmendni ndikimin strukturor të veprimtarive të zbatuara – përmirësime në kuadrin ligjor, metoda, kodin e sjelljes, etj.)	5	
4.5 A ka mundësi që rezultatet/arritjet e pritshme afatgjata do të ndikojnë në kushtet ekonomike lokale dhe/ose cilësinë e jetës në zonën e synuar?		
5. Buxheti dhe efikasiteti i kostos	15	
5.1 A është i kënaqshëm raporti ndërmjet shpenzimeve të parashikuara dhe rezultateve të pritshme? Vlerësim maksimal marini aplikimet të cilat kanë respektuar ndarjen e % së aktiviteteve sipas udhëzuesit.	5	
5.2 A është kostoja e sugjeruar e nevojshme për zbatimin e projektit?	5	
5.3 Buxheti	5	
- a është buxheti i qartë dhe a përfshin edhe pjesën përshkruese? (përfshirë shpjegimet për pajisjet teknike)		
- a përmbushet parimi që kostoja administrative dhe e personelit nuk mund të jetë mbi 20 për qind e buxhetit total?		
- a është buxheti me ndjeshmëri gjinore?		
- a janë përfshirë CV-të dhe përshkrimet e punës, aty ku është e nevojshme?		
Pikët totale maksimale	100	

Njoftimi rreth vendimit

Në çdo rast, nëse projekt-propozimet e tyre miratohen për financim apo jo, të gjithë aplikantëve u njoftohet me shkrim vendimi për projekt-propozimin e tyre brenda 30 ditë pune nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet shpallen në faqen e internetit të Bashkisë **XX** si dhe në tabelën e njoftimeve të bashkisë.

Vendimi për refuzimin e projekt-propozimit apo për mosdhënie fondesh merret nëse:

- Organizata aplikuese, apo/dhe një ose më shumë partnerë të saj, nuk i përmbushin kushtet e thirrjes publike;
- Aktivitetet e projektit janë të papranueshme (p.sh. aktivitetet e propozuara tejkalojnë fushë-veprimin e thirrjes publike për projekt propozime, kohëzgjatja e parashikuar e projektit tejkalon kohën maksimale të lejuar, shuma e kërkuar e fondeve tejkalon shumën e lejuar maksimale, dhe/apo shuma e kërkuar e fondeve është më e vogël se minimumi i lejuar, etj);
- Projekt propozimi nuk ka qenë relevant mjaftueshëm; kapacitetet financiare dhe operative të organizatës aplikuese nuk janë të mjaftueshme, apo projektet e përzgjedhura për financim nuk kanë qenë superior në këto fusha;
- Cilësia e projekt propozimit ka qenë teknikisht dhe financiarisht më e ulët në krahasim me projektet e përzgjedhura për financim.

Kushtet rreth zbatimit të projektit pas miratimit të grantit

Pas marrjes së vendimit për miratimin e grantit, organizatës joqeveritare, projekti i së cilës është miratuar, i ofrohet një kontratë për zbatimin e projektit. Para se të nënshkruajë kontratën dhe nëse është e nevojshme, organizatës mund t'i kërkojen modifikime të caktuara në projekt për ta harmonizuar atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit.

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 7 Projekt Propozimi

Shtojca 8 Buxheti

Shtojca 9 Korniza Logjike

Shtojca 10 Plani i Aktiviteteve dhe dukshmërisë

Shtojca 11 Formulari i identifikimit administrativ

Shtojca 12 Formulari i identifikimit financiar

Shtojca 13 Deklarata për plotësimin e kriterëve

Shtojca A Deklarata e partneritetit

Shtojca B Deklarata për shmangien e konfliktit të interesit

SHTOJCA 7. PROJEKT-PROPOZIMI

PROJEKT-PROPOZIMI STEMA E APLIKANTIT (ORGANIZATËS)

<i>TITULLI I PROJEKTIT (jo më shumë se tetë fjalë)</i>	
<i>EMRI I APLIKUESIT</i>	
<i>PARTNERËT (Përfitues të fondeve)</i>	
<i>BASHKËPUNËTORËT</i>	
<i>FUSHA PRIORITARE</i>	
<i>Nën prioriteti</i>	
<i>GRUPI I SYNUAR /NR I PËRFITUESVE DIREKT (nr dhe përqindja e përfaqësimit sipas seksit)</i>	
<i>VENDI I ZBATIMIT TË PROJEKTIT</i>	
<i>KOHËZGJATJA (nr i muajve)</i>	
<i>BUXHETI TOTAL</i>	
<i>Buxheti ReLOaD</i>	
<i>Bashkëfinancim nga organizata (nëse ka)</i>	

PËRMBLEDHJA

Megjithëse ky seksion jepet që në fillim, përmbledhja e projektit shkruhet vetëm pasi janë plotësuar të gjitha seksionet e tjera të projekt-propozimit. Përmbledhja e projektit përmban të gjitha elementet e projekt-propozimit, si:

1. Nevoja/çështja brenda komunitetit vendor
2. Arsyet dhe rëndësia e projektit për komunitetin vendor
3. Synimet
4. Grupi/et e synuar/a dhe përfaqësimi gjinor
5. Kohëzgjatja e zbatimit dhe buxheti
6. Metodot e përdorura për të arritur qëllimet e projektit
7. Përfitimet e veprimtarive të propozuara për komunitetin vendor

Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se një faqe. Qëllimi është të jepet informacion për të gjitha seksionet e sipërpërmendura si dhe informacion përmbledhës për Komisionin e Vlerësimit. Përmbledhja është seksioni i parë i projekt-propozimit që shqyrton Komisioni i Vlerësimit dhe, si rrjedhim, duhet të jetë e shkurtër, e strukturuar dhe pa ujëra të tepërta.

1. INFORMACION MBI ORGANIZATËN QË APLIKON

Ju lutemi kini parasysh se të dhënat e përfshira në këtë seksion do të përdoren për të vlerësuar plotësimin e kritereve nga aplikantët. I gjithë informacioni i dorëzuar do të shihet nga Komisioni i Vlerësimit dhe do të vlerësohet me anë të tabelës së vlerësimit, sipas seksioneve eliminuese për kapacitetet financiare dhe operative të

aplikantëve. Jepni informacion të hollësishëm për organizatën tuaj dhe kualifikimet e saj për zbatimin e projektit të propozuar. Bëni një përshkrim të shkurtër të historisë së organizatës suaj (**kur dhe si u krijua**), **misionin dhe vizionin** e saj, **çfarë e bën të veçantë organizatën tuaj**, **objektivat dhe strategjitë kryesore për arritjen e këtyre objektivave**.

INFORMACION PËR ORGANIZATËN

Misioni:	
Vizioni:	
Data dhe mënyra e krijimit:	
Qëllimet dhe strategjitë kryesore për arritjen e qëllimeve në përputhje me statutin:	

Përshkrim i shkurtër i skemës organizative dhe sistemit të vendimmarrjes:	
--	--

Bordi drejtues i Organizatës së Shoqërisë Civile (OSHC)/Personat kyçë në Organizatën e Shoqërisë Civile

Emri dhe mbiemri	Profesioni	Funksioni	Seksi	Vitet e përvojës në OSHC

Personat që planifikoni të angazhoni për zbatimin e projektit

Emri dhe mbiemri	Profesioni	Funksioni	Seksi	Vitet e përvojës në OSHC	Me kohë të plotë/të pjesshme

Nëse tabela e mësipërme përfshin partnerët dhe/ose konsulentët, ju lutemi përfshini edhe vendin e tyre të punës në kolonën e "Profesioni".

PROJEKTET E TANISHME DHE PËRVOJA E MËPARSHME NË BASHKËPUNIM ME DONATORËT

Projekti i zbatuar gjatë tri viteve të fundit:

Tema/Fusha	Emri i projektit	Donatori	Kohëzgjatja	Vlera	Nr i personelit të angazhuar (i ndarë sipas gjinisë)

Projektet e tanishme:

Tema/Fusha	Emri i projektit	Donatori	Kohëzgjatja	Vlera	Nr i personelit të angazhuar (i ndarë sipas gjinisë)

Hapësira e zyrave:

Në pronësi ose me qira:	
Në pronësi ose me qira me OSHC të tjera:	
Metra katrorë:	
A keni telefon/faks:	
A keni qasje në internet:	

A keni të gjitha pajisjet e nevojshme për zbatimin e projektit?	
---	--

1. HYRJE

Kur të plotësoni këtë seksion, është e rëndësishme të niseni nga premisa se donatori nuk ka njohuri të mëparshme për komunitetin tuaj vendor dhe problemet që po përpiqeni të zgjidhni. Ju lutem përshkruani se në çfarë mënyre lidhet projekti me një ose më shumë përparësi të thirrjes publike. Bëni një analizë të shkurtër të situatës dhe të rëndësisë së problemit që po përpiqeni të zgjidhni. Nëse është e mundur, jepni tregues të qartë statistikorë për problemin që po përpiqeni të zgjidhni. Një problem i kuptuar dhe përshkruar mirë përbën përligjjen kryesore për projektin. Ky seksion kërkon përgjigje për disa pyetje: Pse është faktikisht i nevojshëm projekti juaj? Përshkruani se cilës nevojë të rëndësishme i përgjigjet ai. E kujt është kjo nevojë? Si do të ndikojë tek burrat/djemetë dhe gratë/vajzat në komunitet?

Problemi që po përpiqeni të zgjidhni dhe nevoja që kërkon përgjigje duhet të jenë të lidhura me synimin dhe qëllimet e organizatës suaj. Nëse projekti i përshkruar në propozim nuk lidhet me veprimtaritë e organizatës suaj, mundësia për të marrë mbështetjen financiare ulet.

I gjithë informacioni i dhënë do të shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit dhe do të vlerësohet në tabelën e vlerësimit, nën seksionin eliminues RELEVANCA, pyetja 2.1.

Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se një faqe.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Bëni një përshkrim të asaj që doni të bëni dhe si mendoni t'i arrini synimet tuaja. Ju lutemi jepni informacione për ndonjë cilësi shtesë të projektit tuaj, si për shembull, qasja e tij novatore dhe shembuj të praktikës së mirë. Kini parasysh se propozimi do të marrë një vlerësim më të lartë nëse bën avokaci për një qasje me bazë të drejtat, barazinë gjinore dhe ka ndikim mbi grupet e pafavorizuara. Nëse projekti përfshin partneritet, ju lutemi përshkruani rolin e partnerit dhe nivelin e përfshirjes së tij në zbatim. Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se një faqe.

I gjithë informacioni i dhënë do të shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit dhe do të vlerësohet në tabelën e vlerësimit, nën seksionin eliminues RELEVANCA, pyetjet 2.4 dhe 2.5.

3. GRUPET E SYNUARA

Përcaktoni qartë grupin e synuar dhe nevojat e tij. Ju lutemi përcaktoni cilët janë treguesit e saktë të përfitimit nga ana e grupit të synuar. Nëse është e mundur, analizoni një numër

burrash/djemsh dhe grash/vajzash brenda grupit të synuar. Ju lutemi rendisni gjithashtu të gjitha palët e interesuara, si ndërmjetësit dhe përfituesit përfundimtarë të projektit.

I gjithë informacioni i dhënë do të shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit dhe do të vlerësohet mbi bazën e tabelës së vlerësimit, nën seksionin eliminues RELEVANCA, pyetjet 2.2 dhe 2.3.

Specifikoni grupin e synuar dhe tregoni përfitimet që do të ketë nga projekti. Projekti duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të madhësisë dhe rëndësisë së grupit të synuar, përfaqësimin gjinor, dhe në veçanti njerëzit që do të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti. Analiza e hollësishme e grupit të synuar mund të bëhet për sa i përket përbërjes së tij etnike, moshës, statusit shoqëror, etj., duke pasur gjithnjë parasysh se secilit grup duhet t'i bëhet një analizë e strukturës gjinore. Nëse përgatitet një analizë e hollësishme, ju lutemi bashkëngjiteni atë si një shtesë e projekt-propozimit.

Ju lutemi siguroni që paraqitja e grupit të synuar të bëhet me ndjeshmëri gjinore (gjithmonë ndani numrat e grave, burrave, djemve e vajzave) së bashku me statusin e tyre të ndryshëm dhe ndikimet tek sekset e ndryshme.

4. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT

Objektivi i përgjithshëm shpjegon thelbin e problemit dhe rëndësinë e projektit, pra përfitimet afatgjata të grupit të synuar nga projekti. Rregullat për përcaktimin e synimi të përgjithshëm të projektit janë:

- 1. Projekti mund të ketë vetëm një synim të përgjithshëm.*
- 2. Synimi i përgjithshëm duhet të lidhet me vizionin e zhvillimit.*
- 3. Ndonëse është e vështirë, madje ndoshta edhe e pamundur, që të matet sukcesi në arritjen e synimit të përgjithshëm përmes treguesve të verifikueshëm, kontributi i tij për realizimin e vizionit përsëri duhet të përcaktohet.*

5. OBJEKTIVI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është të gjejë një zgjidhje për problemin, çka sipas një përkufizimi të gjerë, është një përshkrim i rezultatit të dëshiruar të projektit. Objektivat janë rezultate të verifikueshme të projektit, të paraqitura në mënyrë të tillë që mund të përcaktohet nëse, dhe në çfarë mase, është realizuar projekti. Për shembull, nëse objektivi kryesor është krijimi i një Këshilli Rinor në nivel kombëtar, atëherë nën-objektivat janë krijimi i këshillave rinore nëpër bashki, forcimi i strukturave të tyre, krijimi i rrjeteve, etj. Projekt-propozimi ka zakonisht 2 deri në 3 objektiva specifike, megjithëse në praktikë është gjithashtu e mundshme të ketë vetëm një objektiv specifik. Është e rëndësishme që të gjithë objektivat, ose të paktën një prej tyre, të jetë me ndjeshmëri gjinore. Në hartimin e kësaj pjese të propozimit, ju lutemi siguroni lidhjen me kornizën logjike.

Ju lutemi mos harroni punën kërkimore të nevojshme për matjen me saktësi të suksesit të zbatimit të projektit.

6. REZULTATET E PRITSHME

Në këtë seksion, duhet të rendisni rezultatet e projektit. Kjo formon bazën mbi të cilën do të vlerësohet projekti. Rezultatet e pritshme janë më të hollësishme se synimi i përgjithshëm e objektivat, dhe këto duhet të verifikohen përmes treguesve të verifikueshëm objektivisht (TVO). Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se një faqe.

TVO duhet të jenë:

- *Konkretë: përcaktoni qartë çfarë, ku, kur dhe si e për kë do të ndryshojë situata; përcaktoni qartë përfaqësimin gjinor.*
- *Të matshëm: synimet dhe përfitimet janë të matshme nga ana sasiore; analiza e përfitimeve për të dy sekset është e mundshme.*
- *Të arritshëm: synimet mund të arrihen (duke marrë parasysh burimet dhe kapacitetet në dispozicion brenda komunitetit).*
- *Realiste: mundësia për të arritur atë nivel ndryshimi që pasqyron synimin.*
- *Të kufizuar në kohë: përcaktoni kohëzgjatjen në të cilën do të realizohet secili objektiv.*

Ju lutem siguroni lidhjen me kornizën logjike kur të hartoni këtë seksion.

7. AKTIVITETET

Ky seksion duhet të përfshijë një vështrim të përgjithshëm dhe përshkrim të veprimtarive që do të lejojnë arritjen e rezultateve të përcaktuara. Ato duhet gjithashtu të specifikohen në Planin e Veprimtarive, një nga shtojcat që janë pjesë e projekt-propozimit. Veprimtaritë duhet të jenë të qarta dhe konkrete. Përcaktoni lidhjen e qartë midis veprimtarive dhe synimeve të projektit dhe pastaj përshkruani se përse janë përzgjedhur këto veprimtari specifike. Veprimtaritë e pritshme duhet të grupohen dhe të lidhen me rezultatet relevante të projektit. Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se katër faqe.

8. HIPOTEZAT DHE RREZIQET

*Ky seksion duhet të identifikojë hipotezat dhe rreziqet e mundshme që mund të vënë në rrezik zbatimin dhe/ose suksesin e projektit. Ju lutemi kushtojini vëmendjen e duhur këtij seksioni, sepse ai është shumë i rëndësishëm për identifikimin e ngjarjeve dhe rrethanave në të ardhmen që mund të përbëjnë kërcënim ndaj zbatimit me sukses të projektit. Kjo do t'ju lejojë që të përgatisni një strategji për të shmangur ndonjë rrezik të mundshëm. **Ju lutemi siguroni lidhjen me kornizën logjike kur të hartoni këtë seksion.***

9. KOHËZGJATJA E PROJEKTIT

Ky seksion duhet të tregojë kohëzgjatjen e zbatimit të projektit.

10. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi:

Monitorimi është mbledhja sistematike dhe analizimi i informacionit për ecurinë e projektit. Qëllimi është që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i projektit. Monitorimi bazohet në paketën e rezultateve dhe veprimtarive të planifikuara, të përcaktuara në fazën e planifikimit. Ai ndihmon për të garantuar se zbatimi i projektit është në rrugën e duhur dhe bën të mundur që grupi drejtues të marrë informacione në kohë për çështje të ndryshme. Nëse kryhet ashtu siç duhet, ai përfaqëson një instrument të paçmuar për menaxhimin e mirë dhe krijon një bazë të mirë për vlerësimin. Monitorimi bën të mundur të konfirmohet nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme dhe po përdoren me efikasitet, nëse kapacitetet ekzistuese janë të përshtatshme dhe nëse çdo gjë që është planifikuar është zbatuar.

Monitorimi:

- Është pasqyrim i planit të projektit,
- Ndodh gjatë zbatimit të projektit,
- Zhvillohet në përputhje me një kuadër kohor të përcaktuar më parë.

Ai realizohet mbi bazën e të dhënave (treguesve) sasiore dhe cilësore.

Ju lutemi jepni informacion se kush do ta monitorojë zbatimin e projektit, në çfarë mënyre dhe kur. Monitorimi është një opsion dhe nuk është i nevojshëm për të gjitha projektet. Megjithatë, projektet komplekse dhe të gjata mund të përfitojnë nga monitorimi.

Raportimi për përparimin e zbatimit të projektit dhe raportimi financiar duhet të specifikohen në projekt-propozim dhe duhet të paraqiten në formën e raportimeve të përdymuajshme për dinamikat (veprimtaritë/financat) e zbatimit të projektit brenda afateve kohore të përcaktuara. Përcaktoni gjithashtu se kur do të paraqitet raporti (përshkruesi) përfundimtar.

11. BUXHETI

Ky seksion duhet të përfshijë përshkrimin përshkrues të të gjitha linjave dhe nën-linjave të buxhetit.

Buxheti është shprehja e projektit në vlera monetare. Ky seksion duhet të përshkruajë shpenzimet e pritshme gjatë kohëzgjatjes së projektit. Linjat e buxhetit duhet të përbëjnë një rrjedhë logjike të metodës së punës dhe veprimtarive. Ju lutemi siguroni që sa më shumë linja që të jetë e mundur të bazohen në shpenzime të përcaktuara qartë, jo mbi vlerësime të përafërta. Është gjithashtu e dëshirueshme të tregohen burimet (e mundshme) të financimit nga donatorët e tjerë. Mos harroni kontributin tuaj për projektin (punë vullnetare, pajisje nga projektet e mëparshme, hapësirë pune, etj.). Informacioni në këtë seksion duhet të jetë realist, për shembull, ju nuk do të kërkonte blerje e një fotokopjuesi të ri që kushton 300 000 Lek nëse ajo nuk duhet për zbatimin e projektit.

12. DUKSHMËRIA/VIZIBILITETI

Dukshmëria (publiciteti) duhet të planifikohet siç duhet për të gjitha veprimtaritë e projektit. Dukshmëria duhet të fokusohet në zhvillimet dhe arritjet në zbatimin e projektit dhe jo në arritjet administrative ose procedurale.

Plani i dukshmërisë duhet të përfshihet në Planin e Punës dhe të buxhetohet siç duhet.

Dukshmëria e projektit duhet të informojë partnerët e projektit, grupet e synuara dhe publikun e gjerë për nismat dhe sukseset e projektit. Përcaktoni mjetet e promovimit dhe shpjegoni se si dhe në çfarë faze planifikoni t'i përdorni, përfshirë veprimtaritë publike (konferenca shtypi, botime dhe artikuj gazetash, faqe interneti, pankarta, pllakate, materiale promovuese, fotografi dhe materiale të tjera audio-vizuale, vizita publike, etj.). Ky seksion duhet të përshkruajë se çfarë duhet të bëni dhe si planifikoni të promovoni veprimtaritë tuaja. Veprimtaritë promovuese duhet të jenë të qarta, specifike dhe me ndjeshmëri gjinore.

SHTOJCA 9: KORNIZA LOGJIKE

STEMA E ORGANIZATËS QË ZBATON PROJEKTIN EMRI I ORGANIZATËS: _____

TITULLI I PROJEKTIT: _____

KORNIZA LOGJIKE

		Indikatorët e verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Hipotezat dhe rreziqet
Objektivi i përgjithshëm	Cili është synimi i përgjithshëm, realizimi i të cilit do të mbështetet nga projekti? Projekti nuk duhet të ketë më shumë se sa një synim. Synimi i përgjithshëm nuk do të arrihet vetëm përmes projektit, por do të japë ndihmesën në arritjen e tij.	Cilët janë treguesit e suksesit që lidhen me synimin e përgjithshëm? Rekomandohet që treguesit e suksesit në një mënyrë të ndjeshme nga ana gjinore.	Cilat janë burimet e informacionit që përdoren për treguesit e suksesit?	
Objektivat specifikë	Cilat janë objektivat konkrete që do të realizohen nga ky projekt? Rekomandohet që objektivat të formulohen në mënyrë të ndjeshme nga ana gjinore. Objektivat konkrete duhet të arrihen deri në fund të zbatimit të projektit	Cilët janë treguesit sasiore dhe cilësore të suksesit për përcaktimin e realizimit të objektivave të projektit? Nëse ndonjë nga objektivat është i ndjeshëm nga ana gjinore, rekomandohet që të paraqitet në atë mënyrë.	Cilat janë burimet e informacionit që duhen mbledhur ose që ekzistojnë tashmë? Metodat e përdorura për mbledhjen e informacionit?	Çfarë faktorësh dhe kushtesh kërkohen për realizimin e objektivave të projektit por nuk janë nën kontroll të drejtpërdrejtë? Cilët janë rreziqet që duhet të merren parasysh? A ka mundësi që një nga sekset të jetë më pak i përfaqësuar /përfshirë në zbatimin e projektit?
Rezultatet	Cilat rezultate konkrete do të kontribuojnë në realizimin e objektivave të projektit? A mund të tregohen rezultatet në një mënyrë të ndjeshme gjinore? Nëse po, ju lutem zbatoheni. Rezultatet arrihen përmes zbatimit të suksesshëm të veprimtarive të projektit. Suksesi i zbatimit të projektit do të matet përmes nivelit të realizimit.	Cilët tregues përcaktojnë nëse janë arritur rezultatet e planifikuara dhe në çfarë mase janë realizuar? Treguesit duhet të jenë konkretë, të qartë, të matshëm, dhe me ndjeshmëri gjinore, kudo që është e mundur.	Cilat janë burimet e informacionit për treguesit e suksesit?	Çfarë faktorësh dhe kushtesh duhet të plotësohen që të arrihen rezultatet sipas planit? A varen rezultatet nga angazhimi i plotë i të dy seksve dhe si mund të sigurohet pjesëmarrja e plotë e tyre?
Aktivitetet	Çfarë veprimtarish duhen kryer dhe në çfarë rendi, për të arritur rezultatet?			Çfarë kushtesh duhet të plotësohen përpara fillimit të zbatimit të projektit për të filluar me zbatimin e projektit?

SHTOJCA 11: FORMULARI I IDENTIFIKIMIT ADMINISTRATIV

STEMA E ORGANIZATËS QË ZBATON PROJEKTIN

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT ADMINISTRATIV

EMRI I ORGANIZATËS:

SHKURTESA/AKRONIMI (NËSE KA):

STATUSI LIGJOR:

EMRI, MBIEMRI DHE POSTI I PERSONIT PËRGJEGJËS QË PËRFAQËSON DHE VEPRON NË EMËR TË ORGANIZATËS:

ADRESA:

KODI POSTAR DHE VENDI:

TELEFONI:

FAKSI:

E-MAILI:

FAQJA E INTERNETIT:

_____, ____/____/20____
(vendi, data) (emri dhe mbiemri, nënshkrimi, vula)

SHTOJCA 12. FORMULARI I IDENTIFIKIMIT FINANCIAR

STEMA E ORGANIZATËS E CILA PO ZBATON PROJEKTIN

ZOTËRUESI I LLOGARISË BANKARE:

EMRI (i organizates):

ADRESA:

VENDI/QYTETI:

PERSONI I KONTAKTIT:

TELEFON:

E-MAIL:

BANKA

EMRI I BANKËS KU GJENDET LLOGARIA

ADRESA E BANKES

VENDI/QYTETI

NUMRI I LLOGARISË

___/___/20___

(emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të autorizuar)

(nënshkrimi dhe vula)

SHTOJCA 13. DEKLARATA PËR PLOTËSIMIN E KRITEREVE

STEMA E ORGANIZATËS QË ZBATON PROJEKTIN

DEKLARATA PËR PLOTËSIMIN E KRITEREVE

Unë, i nënshkruari/e nënshkruara

(Emri, mbiemri dhe adresa e përfaqësuesit)

Përfaqësues i /përfaqësuese e

(Emri dhe adresa e organizatës)

Konfirmoj se jam përfaqësuesi ligjshëm i entitetit të regjistruar në Shqipëri dhe se unë, ose organizata e sipërshtuar:

- a)** nuk jemi në gjendje falimentimi,
- b)** nuk kemi ndonjë pagesë të bllokuar me vendim gjyqësor, që çon në humbje të plotë ose të pjesshme të së drejtës sonë për të menaxhuar dhe përdorur pronën tonë,
- c)** nuk jemi objekt i ndonjë procedimi ligjor kundër nesh, përfshirë i urdhrave për pezullim të pagesave që mund çojnë në falimentim dhe që mund të shkaktojnë humbje të plotë ose të pjesshme të së drejtës sonë për të menaxhuar dhe përdorur pronën tonë,
- d)** nuk kemi marrë asnjë vendim fajësie për ndonjë shkelje ose kundërvajtje që lidhet me sjelljen në punë,
- e)** nuk kemi lënë pa përmbushur ndonjë detyrim lidhur me pagimin e sigurimeve shoqërore apo taksave,
- f)** nuk jemi fajtorë për raste të rënda të dhënies së informacionit të rremë për veprimtaritë tona profesionale,
- g)** nuk jemi shpallur fajtorë për shkelje të ndonjë detyrimi kontraktual.

DEKLARATA E BËRË:

(vendi, data)

(emri dhe mbiemri, nënshkrimi)

SHTOJCA A
DEKLARATË PARTNERITETI

STEMA DHE EMRI I ORGANIZATAVE ORGANIZATËS QË DO TË ZBATOJNË PROJEKTIN

Unë, i nënshkruari/e nënshkruara

(Emri, mbiemri dhe adresa e përfaqësuesit së organizatës aplikuese)

Përfaqësues i /përfaqësuese e

(Emri dhe adresa e organizatës aplikuese)

Konfirmoj se jam përfaqësuesi i ligjshëm i organizatës aplikuese, entitetit të regjistruar në Shqipëri.

Unë, i nënshkruari/e nënshkruara

(Emri, mbiemri dhe adresa e përfaqësuesit së organizatës partnere)

Përfaqësues i /përfaqësuese e

(Emri dhe adresa e organizatës partnere)

Konfirmoj se jam përfaqësues i/e ligjshëm/e i organizatës partnere, entitetit të regjistruar në Shqipëri.

Me anë të kësaj deklarate shprehim vullnetin në emër të secilës organizatë për të aplikuar si partnerë për projekt propozimin me titull

_____.

Të gjitha detajet e partneritet dhe detyra për projektin janë të shprehura në projekt propozim.

DEKLARATA E BËRË:

(emri, mbiemri, nënshkrimi dhe vula për organizatën aplikuese)

(emri, mbiemri, nënshkrimi dhe vula për organizatën partnere)

(vendi, data)

SHTOJCA B

DEKLARATA PËR SHMANGIEN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

STEMA E ORGANIZATËS DHE PARTNERËVE QË ZBATOJNË PROJEKTIN

Me anë të kësaj deklarate deklaroj se në pozicionin tim si (zgjidh një nga alternativat më poshtë):

- anëtar i bordit drejtues të organizatës
- anëtar i asamblesë apo organeve të tjera vendimmarrëse të organizatës
- drejtues apo punonjës i organizatës

nuk jam i/e punësuar pranë Bashkisë _____ apo institucione të tjera në varësi të saj (përfshirë këtu edhe pozicione të zgjedhura sipas seksionit 4, të Udhëzuesit për aplikantët – organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) në kuadër të Thirrjes së dytë publike për projekt propozime në Programin rajonal për demokracinë vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)

DEKLARATA E BËRË NGA:

N r	Emri mbiemri	Pozicioni në organizatë	Nënshkrimi
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			

Data, vendi

Vula e OShC